



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.250/6 prot

Datë 24.02.2025

V E N D I M

Nr. 274/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.02.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk dhe “ALPHA STUDIO” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

BOE “Environmental Management Consultants” shpk me NIPT K81317002P dhe “ALPHA STUDIO SHPK me NIPT L91309043N dhe adresë Rruga “Bedri Karapici”, Kompleksi “Tirana Golden Park”, Hyrja e Biznesit, Kati i parë, Nr. 5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tiranë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24-12-2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 06-01-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 13.01.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

- | | |
|--|--------------|
| 1. “Environmental Management Consultants” SHPK | kualifikuar |
| 2. Qendra e Monitorimit të Mjedisit SHPK | skualifikuar |

II.4. Në datën 20.01.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi riklasifikimin përfundimtar si më poshtë:

- | | |
|--|--------------|
| 1. “Environmental Management Consultants” SHPK | skualifikuar |
| 2. Qendra e Monitorimit të Mjedisit SHPK | skualifikuar |

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk rezulton i skualifikuar me arsyetimin si më poshtë vijon:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk nuk plotëson pikën 1/ç të Dst-së /Kriteret e Përgjithshme të përzgjedhjes /kualifikimit, pasi në dokumentet e dorëzuara me nr. prot 2042 dt 15.01.2025 BOE nuk ka paraqitur dokumentin provues për të vërtetuar atë ç’kanë deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nëse janë të dënuar ose nuk kanë qenë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së administratorët/ortak përkatësisht për personat me initiale E.SH, F.SH, K.SH dhe J.SH. Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë të pavlefshme.”.

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 21.01.2025 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 27.01.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 250/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5008 e bashkimit të operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i Hartës Strategjike të Zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga

bashkimi i operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk dhe “ALPHA STUDIO” shpk.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprase” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 250/1 prot., datë 28.01.2025 referuar arsyes së skualifikimit të ofertës ekonomike të bashkimi i operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk dhe “ALPHA STUDIO” shpk.

II.7. Me shkresën me nr. 250/2 prot., datë 10.02.2025 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “Environmental Management Consultants” shpk dhe “Alpha Studio” SHPK”, drejtuar autoritetit kontraktor Bashkisë Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar të dorëzojë pranë KPP-së informacion të hollësishëm mbi procedurën e prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën me nr. 4056 prot., datë 20.02.2025 me lëndë “Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës”, protokolluar me tonën me nr. 250/3 prot., datë 20.02.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk dhe “ALPHA STUDIO” shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, informacionit, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentave të kriterëve për kualifikim:

Arsyeton

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për efekt të shqyrtimit të ankesës nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” shpk & “ALPHA STUDIO”, duke marrë parasysh faktin së në ekstraktin historik të subjektit “Environmental Management Consultant” rezulton vendosja e një mase sigurimi personal ndaj personit nën hetim E.Sh "Ndalim i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale dhe afariste", kërkoj nga BOE ankimues vënien në dispozicion të dokumentacionit "vërtetim i gjendjes gjyqësore" si dokumentacion shoqërues provues i vetëdeklarimit sipas parashikimeve të nenit 26 pika 2 gërma c, VKM nr. 285, dt.19.5.2021, për të gjithë individët për të cilët është bërë ky

deklarim nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, në mënyrë që të provohet që nuk jeni në kushtet e nenit 76 të L.P.P.

Pasi administroi materialin e nevojshëm të dërguar nga BOE me shkresën nr.6132 prot. Dt.3.2.2025 "Dorëzim dokumentacioni për procedurën me Nr.REF-34359-12-23-2024", arriti në konkluzionin se të dhënat e "vërtetimeve të gjendjes gjyqësore" të dorëzuara nga BOE si dokumentacion shoqërues provues i vetëdeklarimit të bërë nga ky i fundit, përputhen me të dhënat e deklaruara.

Përsa më lart, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Pas shqyrtimit dhe arsyetimit të ankesës së bërë nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO" Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në unanimitet vendosi të pranojë pretendimet e parashtruara nga pala ankimuese.

Konkluzionet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas vlerësimit të ankesës dhe pretendimit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO", arrin në konkluzion se pretendimi i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO" qëndron dhe

VENDOS:

- 1.Të pranojë ankesën e Bashkimit Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO"*
- 2.Autoriteti Kontraktor do të vërë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar (nëse ka) brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 3. Një kopje e vendimit i komunikohet me shkrim ankimuesve dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.*

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ nuk rezulton, të jenë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën me nr. 4056 prot., datë 20.02.2025 me lëndë “Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës”, protokolluar me tonën me nr. 250/3 prot., datë 20.02.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk dhe “ALPHA STUDIO” shpk, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i ankesës. Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

“[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, informacionit, dokumentave të tenderit dhe procesverbalit të argumentave të kritereve për kualifikim:

Arsyeton

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për efekt të shqyrtimit të ankesës nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & "ALPHA STUDIO", duke marrë parasysh faktin se në ekstraktin historik të subjektit “Environmental Management Consultant” rezulton vendosja e një mase sigurimi personal ndaj personit nën hetim E.Sh “Ndalim i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale dhe afariste”, kërkoj nga BOE ankimues vënien në dispozicion të dokumentacionit “vërtetim i gjendjes gjyqësore” si dokumentacion shoqërues provues i vetëdeklarimit sipas parashikimeve të nenit 26 pika 2 gërma c, VKM nr. 285, dt.19.5.2021, për të gjithë individët për të cilët është bërë ky deklaram nga

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, në mënyrë që të provohet që nuk jeni në kushtet e nenit 76 të L.P.P.

Pasi administroi materialin e nevojshëm të dërguar nga BOE me shkresën nr.6132 prot. Dt.3.2.2025 "Dorëzim dokumentacioni për procedurën me Nr.REF-34359-12-23-2024", arriti në konkluzionin se të dhënat e "vërtetimeve të gjendjes gjyqësore" të dorëzuara nga BOE si dokumentacion shoqërues provues i vetëdeklarimit të bërë nga ky i fundit, përputhen me të dhënat e deklaruara.

Përsa më lart, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Pas shqyrtimit dhe arsyetimit të ankesës së bërë nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" shpk & "ALPHA STUDIO" Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në unanimitet vendosi të pranojë pretendimet e parashtruara nga pala ankimuese.

Konkluzionet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës,

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas vlerësimit të ankesës dhe pretendimit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO", arrin në konkluzion se pretendimi i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO" qëndron dhe

VENDOS:

- 1.Të pranojë ankesën e Bashkimit Operatorëve Ekonomikë "ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS shpk & ALPHA STUDIO"*
- 2.Autoriteti Kontraktor do të vërë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar (nëse ka) brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 3. Një kopje e vendimit i komunikohet me shkrim ankimuesve dhe Komisionit të Prokurimit Publik”*

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave,

Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe për këtë fakt, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Environmental Management Consultants” shpk & “ALPHA STUDIO” shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

